



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 274/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z.Blerim Dina- Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.T. “Eing Com” –Podujevë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetet e prokurimit me titull: “Furnizim i shportave të xhepit dhe ulëseve”, me numër të prokurimit: 616-18-5173-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë, më datën: 03.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.T. “Eing Com” – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim i shportave të xhepit dhe ulëseve”, me numër të prokurimit: 616-18-5173-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.
- II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim i shportave të xhepit dhe ulëseve”, me numër të prokurimit: 616-18-5173-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
- III. **I SHOIPTOHET GJOBË**, autoritetit kontraktues Komuna Prishtinë në shumë prej 5,000.00 € (pesë mijë euro), për mos zbatimin të urdhëresës së Panelit Shqyrtues, më nr. të protokollit PSH nr: 83/19, të datës: 02.04.2019, siç parashihet në nenin 131 të LPP-së.
- IV. Mos respektimi i akteve juridike të nxjerra nga OSHP, detyron OSHP që të veprojë në pajtim me nenin 105 paragrafi 2 pika 12 e LPP-së.
- V. **OBLIGOHET**, autoriteti kontraktues /Komuna e Prishtinës që gjobën e lartë cekuar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, në xhirollogarinë e OSHP-së Nr. 1000 4300 7000 5756 / Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

- VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.T. "Eing Com" –Podujevë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:13.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:09.08.2018

Njoftimi mbi anulimin e AP është bërë dt: 03.09.2018

Kërkesa për rishqyrtim është bërë dt: 07.09.2018

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është bërë dt: 07.09.2018

Parashtrimi i ankesës ne OSHP është bërë dt: 14.10.2018

Vendimi i OSHP-së është bërë dt:24.10.2018

Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar është bërë dt: 14.11.2018

Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulim te AP është bërë dt: 14.11.2018

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është bërë dt: 19.11.2018

Parashtrimi i ankesës ne OSHP është bërë dt: 29.11.2018

Vendimi i OSHP-së është bërë dt:08.01.2019

Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulim te AP është bërë dt: 06.02.2019

Kërkesa për rishqyrtim është bërë dt: 11.02.2019

Vendimi i Autoritetit Kontraktues është bërë dt: 13.02.2019

Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulim te AP është bërë dt: 16.05.2019

Kërkesë për rishqyrtim është bërë dt: 21.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 23.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.N.T. "Eing Com" –Podujevë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.06.2019 me nr. 274/19, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me

aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim i shportave të xhepit dhe ulëseve", me numër të prokurimit: 616-18-5173-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Nenin 28, dhe 41 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.06.2019 ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 19.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: OE ankuese "N.N.T." EING COM" -Podujevë, pretendon se AK Komuna e Prishtinës nuk i ka respektuar këto nene :

Nenin 7 të LPP-së,

Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,

Neni 69 i LPP-se nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose profesionale

Nenin 41 i Rregullave dhe RRUOPP-ik -Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,

Neni 28 i Rregullave dhe RRUOPP-se-Kriteret e dhënies së kontratës .

Ekspertja konstaton se të gjitha këto pretendime janë shqyrtuar nga Paneli shqyrtues i OSHP-së dhe të njëjtat konsiderohen, çështje të Gjykuara".

Sepse kemi dy (2) vendime nga OSHP-ja dhe një Urdhëresë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së .

Vendimi i OSHP-së përkatësisht i Panelit Shqyrtues nr, 488/18, të datës 24.10.2018 ,

Vendimi i OSHP-së përkatësisht i Panelit Shqyrtues nr.694/19 i datës 08.01.2019 dhe kemi ,

Urdhëresë nga OSHP-së përkatësisht nga Panelit Shqyrtues nr: 83/19 të datës 12.04.2019.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi i shportave të xhepit dhe ulëseve" me nr. të prokurimit 616-18-5173-121 "

Andaj bazuar në këto vendime dhe në urdhëresë konsideroj se këto pretendime janë "çështje të Gjykuara"

Sa i përket pretendimit të OE.ankues, se AK-së nuk ka dërguar Letër Standarde për anulimin e aktivitetit siç parashihet me ligj, e as nuk e kanë publikuar ne platformën e e-prokurimit, vetëm na kanë dërguar një e-mail në të cilin thuhet që nuk mund të vazhdojmë me këtë aktivitet të prokurimit për shkak disponueshmërisë së mjeteve.

Ekspertja mendon se pretendimi është pjesërisht bazuar sepse në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë Letër Standarde edhe në E-prokurim nuk ka Letër Standarde mirëpo ekziston Njoftimi mbi Vendimi e AK-së të cilit i është bashkangjitur edhe Emaili i Kryetarit të Komunës z.Shpend Ahmeti me të cilin email informon se nuk e nënshkruan Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmerin e fondeve.

Edhe emaili dërguar OE.ankues në të cilin thuhet që nuk mund të vazhdojmë me këtë aktivitet të prokurimit për shkak disponueshmërisë së mjeteve. Konsideroj se është i mjaftueshëm për informim.

Ekspertja konstaton se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE.ankues, se nuk ka kurrfarë kuptimi me u arsyetua se zyrtari kryesor financiar nuk e nënshkruan disponueshmërisë së mjeteve pasi që me rastin e hapjes së procedurës për një aktivitet të prokurimit duhet të nënshkruhet dhe ka qenë aty (DNPDPF) dhe sekjo është e qëllimshme dhe tendencioze nga ana e AK-së Komuna e Prishtinës.

Pretendimi është i pa qëndrueshëm sepse në bazë të Nenit 9 të LPP-së dhe paragrafit 8.7 të RRUOPP - Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve, Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratë janë të obliguar, para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDPF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale.

Pretendimi pjesërisht i pranueshëm sepse AK-së nuk ka dëshmuar me ndonjë dokument -vendim se si kanë ndryshuar gjendja financiare e cila ka qenë e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj Ekspertja konstaton se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik NNT "Eing Com" ta aprovoj si pjesërisht të bazuar dhe të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, ekspertja profesionale e prokurimit u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertës shqyrtuese, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Podvorica deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertës që kjo lëndë të kthehet në rivlerësim duke qenë të informuar se për këtë lëndë janë lëshuar 2 vendime nga OSHP-ja dhe një urdhëresë e të cilat nuk janë zbatuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Vlen të theksohet se buxheti për këtë procedurë është zotuar para inicimit të këtij Aktiviteti dhe nuk mund të arsyetohet vetëm në rast kur ka ndonjë fatkeqësi natyrore, në këtë rast edhe nga parashikimi i buxhetit për vitin 2019 këto mjete janë të zotuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Panelit i ofroj edhe listën e projekteve të cilat i ka planifikuar Autoriteti Kontraktues të ekzekutojë në vitin 2019 e në mesin e tyre shihet qartë edhe zotimi i mjeteve për këtë aktivitet.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroj: Departamenti i prokurimit ka formuar komisionin e rivlerësimit në bazë të vendimit të OSHP-së, me nr. 83/19 dhe ka propozuar për dhënie të kontratës OE ankues N.N.T. "Eing Com" mirëpo nuk ka pasur mundësi të vazhdojë me këtë aktivitet pa aprovimin e disponueshmërisë së mjeteve nga ana e ZKA-së.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Qëndroj prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Podvorica deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovoj kërkesën tonë dhe ta urdhëroj Autoritetin Kontraktues të zbatoj urdhëresën 83/19.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroj: Propozojmë që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues "N.N.T." "EING COM" - Podujevë, pretendon se AK Komuna e Prishtinës nuk i ka respektuar këto nene :

Nenin 7 të LPP-së,

Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
Neni 69 i LPP-se nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose profesionale
Neni 41 i Rregullave dhe RRUOPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,
Neni 28 i Rregullave dhe RRUOPP-së, -Kriteret e dhënies së kontratës.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se të gjitha këto pretendime të lartpërmendura janë shqyrtuar nga Paneli shqyrtues i OSHP-së, dhe të njëjtat konsiderohen, çështje të Gjykuara. Për faktin se kemi dy (2) vendime nga OSHP-ja, dhe një Urdhëresë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së të cilat janë :

Vendimi me PSH.nr. 488/18, i datës: 24.10.2018 ,

Vendimi me PSH.nr.694/19, i datës 08.01.2019, dhe Urdhëresë me nr: 83/19, e datës: 12.04.2019.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i shportave të xhepit dhe ulëseve” me nr. të prokurimit 616-18-5173-121 “ andaj bazuar në këto vendime dhe në urdhëresë konstatohet se këto pretendime janë “çështje të Gjykuara”

Sa i përket pretendimit të OE ankues “N.N.T.” EING COM” – Podujevë, se autoritetit kontraktues Komuna Prishtinë, se nuk ka dërguar Letër Standarde për anulimin e aktivitetit siç parashihet me ligj, e as nuk e kanë publikuar në platformën e e-prokurimit, vetëm se na kanë dërguar një email në të cili thuhet që nuk mund të vazhdojmë me këtë aktivitet të prokurimit për shkak disponueshmërie se mjeteve.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendura është pjesërisht i bazuar për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë Letër Standarde edhe në E-prokurim nuk ka Letër Standarde mirëpo, ekziston Njoftimi mbi Vendimi e AK-së, të cilit i është bashkangjitur edhe Emaili i Kryetarit të Komunës z.Shpend Ahmeti, me të cilin email informon se nuk e nënshkruan Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërinë e fondeve.

Edhe emaili i dërguar OE-së ankues në të cilin thuhet që nuk mund të vazhdojmë me këtë aktivitet të prokurimit për shkak disponueshmërisë se mjeteve. Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit vlerëson se OE në fjalë mjaftueshëm është informuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, “N.N.T.” EING COM” - Podujevë, se nuk ka kurrfarë kuptimi me u arsyetua se zyrtari kryesor financiar nuk e nënshkruan disponueshmërisë e mjeteve pasi që me rastin e hapjes së procedurës për një aktivitet të prokurimit duhet të nënshkruhet dhe ka qenë aty (DNPDF) ku OE në fjalë pretendon se është e qëllimshme dhe tendencioze nga ana e AK-së Komuna e Prishtinës.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se në bazë të nenit 9 të LPP-së,

dhe paragrafit 8.7 të RRUOPP -Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve, Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratë janë të obliguar, para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale. Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se autoriteti kontraktues nuk ka dëshmuar me ndonjë dokument -vendim se si kanë ndryshuar gjendja financiare e cila ka qenë e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si më lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, dhe se oferta e OE ankues është bërë brenda planifikimit buxhetor të AK-së. Prandaj, aktiviteti i prokurimit nuk ka asnjë bazë ligjore për anulim.

Paneli shqyrtues konstaton se AK KK Prishtinë nuk ka respektuar Vendimet e OSHP-së, PSH .nr.488/18, të datës: 24.10.2018, PSH .nr 694/19, i datës 08.01.2019, dhe Urdhëresë e OSHP-së, PSH nr: 83/19, të datës: 12.04.2019.

Paneli shqyrtues obligon Autoriteti kontraktues Komuna Prishtinë, që gjatë rivlerësimit të respektojë Vendimet e OSHP-së, PSH .nr.488/18, të datës: 24.10.2018, PSH .nr 694/19, i datës 08.01.2019, dhe Urdhëresë e OSHP-së, PSH nr: 83/19, të datës: 12.04.2019, sepse mos respektimi i akteve juridike të nxjerra me par nga OSHP për të njëjtin aktivitet të prokurimit detyron OSHP që të veprojë në pajtim me nenin 105 paragrafi 2 pika 12 të LPP-së në të cilin nën thuhet: Të lëshojnë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që të ndihmojnë OSHP-në në ekzekutimin e një urdhri të OSHP-së. Paneli shqyrtues sqaron se mos respektimi i akteve të OSHP-së të cekura si më lart do ta detyrojë Organin Shqyrtues të Prokurimit që të lëshojë një urdhër zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e ligjit në mënyrë që ta ndihmojnë OSHP që të ndikojë në autoriteti kontraktues në zbatimin e urdhëresave dhe vendimeve të cekura si më lart.

Paneli shqyrtues konstaton se mos respektimi i Urdhëresë nr. PSH 83/19, të dt.02.04.2019 për zbatimin e vendimit me numër: PSH nr. 488/18, të datës: 24.10.2018, dhe vendimi PSH nr.694/19, i datës:08.01.2019, nga ana e AK-së Komunës e Prishtinës, e detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së, të veprojë ndaj autoritetit kontraktues, për shkak se janë bërë shkelje të rënda esenciale të LPP-së, duke mos u zbatuar Urdhëresat e PSH. nr. 83/19, të dt: 02.04.2019 dhe vendimi i PSH. të cekura si më lart.

Paneli shqyrtues ju bëjmë me dije se vendimet e OSHP-së, janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejtë ti drejtohen gjykatës kompetente brenda afatit ligjor me anë të mjeteve të rregullta juridike konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtinë
- 1x1 OE–N.N.T. “Eing Com” – Podujevë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.